

KOSOVO POLICE

MBROJTËSI

Vëllimi IX - Nr. 7 / 2017 ... drejtësi për të gjithë



EMBLEMAT ZYRTARE TË POLICISË SË KOSOVËS



KOMENT I KRYEREDAKTORIT



Baki KELANI


Policia e Kosovës, si një nga institucionet më të rëndësishme të zbatimit të ligjit, përveç arritjes së objektivave kryesore dhe realizimit të detyrave ligjore që përmbajnë, por nuk kufizohen vetëm me mbrojtjen e jetës, pronës dhe ofrimin e sigurisë për të gjithë, parandalimin e rrezikut ndaj qytetarëve, mbikëqyrjen dhe kontrollin në trafik deri te menaxhimi i kufirit shtetëror, në fokus ka pasur edhe bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe profesional me media dhe qytetarët në përgjithësi. Ky bashkëpunim ka qenë gjithnjë i një fryme mirëkuptimi dhe transparence të plotë, duke u bazuar edhe në qëllimet e përbashkëta strategjike për një ambient të qetë dhe të sigurt për të gjithë.

Duke pasur parasysh nevojën e informimit të opinionit të gjerë lidhur me zhvillimet e përgjithshme të sigurisë në vend dhe më gjerë, Policia e Kosovës, respektivisht Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun në nivel qendror, si dhe zyrat rajonale për informim, në vazhdimësi kanë publikuar raporte, informacione relevante dhe komunikata që kanë rëndësi për opinionin, mediat dhe qytetarët në veçanti në aspektin e sigurisë.

Për të qenë sa më transparentë dhe për të njoftuar opinionin dhe mediat lidhur me zhvillimet në vend që ndërlidhen me sigurinë, Zyra për Informim në nivelin qendror në baza ditore publikon raportin policor ku përfshihen të përshkruara rastet dhe statistikat që kanë të bëjnë me incidente, aksidentet apo ndodhitë tjera që mund të ngjallin interes të publikut. Në vazhdimësi ne kemi mbajtur kontakte aktive me partnerët tanë dhe kjo përpjekje ka rritur në masë të madhe edhe nivelin e vlerësimeve pozitive për Policinë e Kosovës, si nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Vlerësimi nga organizata vendore dhe ndërkombëtare ka forcuar në vazhdimësi bindjen se Policia e Kosovës bazuar në pavarësinë institucionale, profesionalizimin dhe transparencën e treguar meriton të cilësohet si një nga institucionet më të pavarura dhe më të besueshme në Ballkanin perëndimor.

Arritjet e Policisë së Kosovës, si në aspektin e mbajtjes së rendit dhe sigurisë po ashtu edhe në garantimin e funksionimit të institucioneve shtetërore, janë kurorëzuar edhe me qasjen transparente të zyrtarëve kompetentë për marrëdhënie me publikun dhe mediat me ofrimin e informacioneve të rëndësishme për opinionin e gjerë dhe mundësisë së qasjes sa më të shpejtë në ato informacione.

Policia e Kosovës do të vazhdojë bashkëpunimin aktiv me partnerët e saj në funksion të garantimit të ligjit dhe sigurisë së përgjithshme dhe si gjithnjë do të jetë e udhëhequr nga profesionalizmi, vendosmëria dhe transparenca.



Revistë e Policisë së Kosovës

Botues:

ZIMP

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie
me Publikun e PK-së
DPP - Prishtinë

Kryeredaktor:

Baki KELANI

Redaktor:

Daut HOXHA

Tel.: 038 5080 1243

Tel.: 038 5080 1237

Mob.: 044 506 308

Mob.: 044 181 418

E-mail:

baki.kelani@kosovopolice.com

daut.hoxha@kosovopolice.com

zimp@kosovopolice.com

Bashkëpunorë:

Bajram KRASNIQI

Mentor ÇAKOLLI

Dr. Lindita KAJTAZI

Merita CANOLLI - GASHI

Sami SALLAHU

Osman OSMANI

Dizajni:

Çajup KAJTAZI

Lektor:

Leonora FEJZULLAHU - RUHANI

Fotograf:

Arbër MUHADRI

Telefon: 192

info@kosovopolice.com

www.kosovopolice.com

facebook.com/KosovoPolice

twitter.com/Kosovo_Police

KRYEMINISTRI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Z. RAMUSH HARADINAJ, VIZITOI POLICINË E KOSOVËS, 4

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË KOSOVËS Z. SHPEND MAXHUNI, PRITI NË TAKIM ZYRTAR DREJTORIN E POLICISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË Z. SELAMI ALTINOK DHE STAFIN E TIJ SHOQËRUES, 5

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË KOSOVËS Z. SHPEND MAXHUNI PRITI NË TAKIM ZYRTAR PROKURORIN E PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË TURQISË Z. MEHMET AKARCA, 6

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË KOSOVËS, Z. SHPEND MAXHUNI, PRITI NË TAKIM ZYRTAR GJENERALIN E KFOR-IT, MG GIOVANNI FUNGO, 6

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË KOSOVËS Z. SHPEND MAXHUNI DHE MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME Z. FLAMUR SEFAJ REALIZUAN NJË VIZITË ZYRTARE NË STACIONIN POLICOR VERIU-PRISHTINË, 7

NË DITËN E SHËNIMIT TË 18 VJETORIT TË THEMELIMIT TË POLICISË SË KOSOVËS, 17 MAJORË AVANCOHEN NË GRADËN NËNKOLONEL, 8

POLICISË SË KOSOVËS I SHTOHN EDHE 27 MAJORË, 9

INTERVISTË ME TOGER BAJRAM SHABANI NGA SEKTORI PËR PLANIFIKIM PERMANENT NË POLICINË E KOSOVËS, 10-11

ASPEKTE TEORIKE TË TRAJTIMIT TË SIGURISË SË PËRGJITHSHME DHE NDIKIMI IDEOLOGJIK, 12

POLICIA E KOSOVËS REALIZON AKTIVITETE SHITESË ME QËLLIM TË NGRITJES SË SIGURISË NË TRAFIK, 13

KALENDARI PËR VITIN E RI 2018, 14-15

ROLI I TË RINJVE NË IDENTIFIKIMIN DHE PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM QË SHPIE NË TERRORIZËM, 15-16

PËR HERË TË PARË POLICIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS ORGANIZON PROGRAM FESTIV ME FËMIJËT, PËR TË SHËNUAR 1 QERSHORIN, DITËN NDËRKOMBËTARE TË FËMIJËVE, 16

PROFIL - PUNA DHE SHKATHTËSITË E VEÇANTA TË NJË PERSONI TË VEÇANTË, 17

PROFESIONISTJA - POLICJA NËNË, SFIDË QË KËRKON MUND DHE PËRKUSHTIM, 18

ICITAP-I AMERIKAN NË BASHKËPUNIM ME “NORTHWESTERN UNIVERSITY, CENTER FOR PUBLIC SAFETY” MBËSHETET POLICINË E KOSOVËS, 19

VITAMINA ‘D’ PJESË

THELBËSORE E SHËNDETIT, 20

OPERACIONE-DISA NGA OPERACIONET E SUKSESSHME TË VITIT 2017 NGA DEPARTAMENTI PËR HETIMIN E KRIMIT, 22-23

ARKIVI QENDROR DHE MISIONI I ARKIVISTIT NË POLICINË E KOSOVËS, 24-25

KURIOZITETE, 26-27

FOTOLAJM, 28

PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të disa shkrimeve të këtij botimi nuk paraqesin medeomos qëndrimet ose vështrimet zyrtare të PK-së.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, vizitoi Policinë e Kosovës

Me 25 shtator 2015, Policinë e Kosovës e ka vizituar kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ku janë diskutuar çështje të rëndësishme rreth sigurisë së përgjithshme në vend.

Kryeministri Haradinaj, i shoqëruar edhe nga ministri i Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, janë pritur në takim nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Shpend Maxhuni.

Në takimin i cili u realizua në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të PK-së, z. Shpend Maxhuni fillimisht falënderoi Kryeministrin z. Haradinaj për vizitën e tij dhe njëkohësisht njoftoi të pranishmit mbi angazhimet, aktivitetet dhe realizimin e objektivave të Policisë së Kosovës, të cilat kanë treguar rezultate pozitive në fusha të ndryshme.

Policia e Kosovës vazhdon të mbetet e përkushtuar në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të saja ligjore, në funksion të zbatimit të ligjit, me qëllim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike në vend. Së bashku ata kanë vizituar edhe Qendrën Operative të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, për të parë nga afër punën që bëhet. Kryeministri Haradinaj ka falënderuar të gjithë policët e Kosovës për punën që e bëjnë në sigurimin e qytetarëve dhe pronës së tyre. "Rendi dhe ligji është nevojë, është interes i të gjithë qytetarëve të vendit, kudo që jetojnë



në Kosovë, të cilësdo përkatësie. Është po ashtu edhe parametër që tregon aftësitë e Kosovës për anëtarësim në mekanizmat ndërkombëtarë, pra drejt BE-së dhe organizatat tjera të sigurisë. Njëkohësisht është edhe një tregues se jeta në vendin tonë në çfarë norme të sigurisë zhvillohet. Këtu jemi në institucionin që e bart përgjegjësinë kryesore, barrën kryesore, që çdo herë është në vijën e parë, që është në front për të zbatuar ligjin, për të zbatuar rendin - Policia e Kosovës. I falënderoj për punën e madhe që e bëjnë të gjithë kudo që janë në detyra, për sigurinë që e bëjnë për ne, për qytetarët, për pronën", ka thënë kryeministri Haradinaj. Në takim është biseduar

edhe për vjedhjet në prona, por fokusi kryesor në siguri mbetet parandalimi i shpërndarjes së narkotikëve tek fëmijët. "Diskutuam edhe për disa detyra më direkte, më urgjente që i kemi. Unë e kisha veçuar një ndër to, që është droga apo narkotikët tek fëmijët, aksesit ose mundësia që trafikantë të ndryshëm të plasojnë narkotikë tek fëmijët e moshës minore. Kjo është e patolerueshme. Besoj që është një pajtim i të gjithë neve që s'do të mundet kush që në Kosovë t'iu ofroj fëmijëve drogë, s'do të mundet kush të shtijë dorë në shkollat tona, s'do të mundet kush të rrezikojë fëmijët tanë. Për këtë besoj që kemi dakordim të gjithë ne", ka thënë kryeministri.





Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Shpend Maxhuni, priti në takim zyrtar drejtorin e Policisë së Republikës së Turqisë, z. Selami Altinok dhe stafin e tij shoqërues

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Shpend Maxhuni, i shoqëruar nga stafi i lartë i tij, me 24.08.2017 ka pritur në takim zyrtar drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Turqisë z. Selami Altinok, po ashtu i shoqëruar nga ambasadorja e Republikës së Turqisë në RKS znj. Kivcili Kiliç.

Në takimin i cili u realizua në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të PK-së, z. Shpend Maxhuni fillimisht falënderoi z. Altinok për vizitën e tij dhe njëkohësisht njoftoi të pranishmit mbi angazhimet, aktivitetet dhe objektivat e Policisë së Kosovës, të bazuara në planin zhvillimor strategjik të Policisë.

Drejtori Maxhuni njoftoi të pranishmit se Policia e Kosovës ka kapacitete profesionale dhe është e përgatitur që të ofrojë siguri, të luftojë kundër krimit të organizuar si dhe të bashkëpunojë ngushtë me organizatat policore, me qëllim të avancimit të mëtejme të bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e sigurisë dhe parandalimit të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ndërsa drejtori i Turqisë



z. Altinok falënderoi z. Maxhunin për pritjen e ngrohtë dhe njëkohësisht vlerësoi lart punën e Policisë së Kosovës në përgjithësi, e në veçanti në bashkëpunimin e deritanishëm të treguar me autoritetet policore turke. Delegacioni i Turqisë konfirmoi mbështetjen dhe përkrahjen e pakursyer për Policinë e Kosovës me të

gjitha kapacitetet e saj, duke përfshirë edhe trajnimet e nevojshme në fusha të ndryshme për personelin policor. Gjatë takimit u zotua për bashkëpunim të ndërsjellë edhe në të ardhmen, me qëllim të avancimit të mëtejme të PK-së, duke përfshirë edhe përkrahjen për inkuadrimin në Interpol dhe mekanizma tjerë ndërkombëtarë policorë.

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Shpend Maxhuni, priti në takim zyrtar gjeneralin e KFOR-it, MG Giovanni FUNGO

Në aspektin e bashkëpunimit me partnerët kryesorë të Policisë së Kosovës, me 30 gusht 2017, në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme, z. Shpend Maxhuni priti në një takim gjeneralin e KFOR-it, MG Giovanni FUNGO.

Temë e diskutimit me gjeneralin e KFOR-it ishte situata e përgjithshme e sigurisë në vendin tonë dhe çështje tjera me interes për sigurinë e qytetarëve.

Drejtori i Përgjithshëm, z. Maxhuni e falënderoi gjeneralin për përkrahjen e vazhdueshme dhe ndarjen e



mendimeve të përbashkëta për bashkëpunimin ndërmjet dy mekanizmave krucialë për çështjet e sigurisë por edhe për projekte të

avancimit reciprok. Në të njëjtën kohë gjenerali i KFOR-it falënderoi dhe vlerësoi lart përkushtimin dhe profesionalizmin e Policisë së Kosovës në ofrimin e sigurisë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Format e bashkëpunimit reciprok në parandalimin proaktiv të aktiviteteve të cilat do të afektojnë në sigurinë e përgjithshme në vend dhe rajon do të jenë prioritet në të ardhmen për të dyja palët.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Shpend Maxhuni priti në takim zyrtar prokurorin e Përgjithshëm të Republikës së Turqisë, z. Mehmet Akarca

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Shpend Maxhuni, së bashku me kryeprokurorin e Shtetit z. Aleksandër Lumezi, me 4 tetor 2017 kanë pritur në takim zyrtar prokurorin e Përgjithshëm të Republikës së Turqisë z. Mehmet Akarca, i cili ishte i shoqëruar nga ambasadorja e Republikës së Turqisë në RKS znj. Kivencilim Kiliç.

Në takimin i cili u realizua në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të PK-së, z. Shpend Maxhuni fillimisht i dëshiroi mirëseardhje z. Akarca dhe njëkohësisht e falënderoi atë për vizitën e tij në Policinë e Kosovës.

Gjatë takimit nga drejtori Maxhuni të pranishmit u njoftuan mbi angazhimet, aktivitetet dhe rezultatet e arritura përmes realizimit të objektivave strategjike të Policisë së Kosovës, që dalin nga plani zhvillimor strategjik i Policisë. Drejtori Maxhuni po ashtu i njoftoi të pranishmit se Policia e Kosovës ka kapacitete profesionale dhe është e përgatitur që të ofrojë siguri, të luftojë kundër krimit të organizuar si dhe të bashkëpunojë



ngushtë me organizatat policore, me qëllim të avancimit të mëtejme të bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e sigurisë dhe parandalimit të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ndërsa prokurori i Turqisë z. Akarca falënderoi z. Maxhuni për pritjen e ngrohtë dhe njëkohësisht vlerësoi lart punën e Policisë së Kosovës në përgjithësi, e në veçanti në bashkëpunimin e deritanishëm të

treguar me autoritetet turke. Delegacioni i Turqisë konfirmoi mbështetjen dhe përkrahjen e pakursyer për Policinë e Kosovës me të gjitha kapacitetet e saj, me qëllim të ngritjes profesionale dhe avancimit të mëtejme në fusha të ndryshme. Gjatë takimit të dy palët u zotuan për bashkëpunim të ndërsjellë edhe në të ardhmen, bashkëpunim ky i cili është në interes të përbashkët.



Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z.Shpend Maxhuni dhe ministri i Punëve të Brendshme, z.Flamur Sefaj, realizuan një vizitë zyrtare në stacionin policor Veriu-Prishtinë

Në kuadër të agjendës së përbashkët, ministri i Punëve të Brendshme z. Flamur Sefaj së bashku me drejtorin e Përgjithshëm të PK-së z. Shpend Maxhuni vizituan stacionin policor Veriu në Prishtinë.

Delegacioni u prit në një takim njoftues nga komandanti i stacionit policor dhe stafi menaxhues i këtij stacioni.

Ministri Sefaj dhe drejtori Maxhuni u njoftuan me punën dhe angazhimet e personelit policor të këtij stacioni, në të mirë të sigurisë së qytetarëve të zonës së përgjegjësisë të cilën e mbulon ky stacion policor.

Stacioni policor Veriu në Prishtinë mbulon një zonë të madhe të përgjegjësisë, ku nga të gjitha vlerësimet situata e sigurisë është e qetë dhe stabile.

Për të gjitha shqetësimet nga aspekti i sigurisë që kanë qytetarët, zyrtarët pranë këtij stacioni i trajtojnë me prioritet, efikasitet dhe profesionalizëm të lartë.

Gjatë vizitës në këtë stacion policor

pashmangshëm u trajtuan edhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen në aspektin logjistik-infrastrukturor, për faktin se objekti dhe hapësira e punës që shfrytëzohet nga personeli policor në këtë stacion nuk i plotëson as kushtet minimale për punë.

Drejtorja e përgjithshme në synimin e zgjidhjes së këtij problemi, disa herë ka adresuar kërkesa tek institucionet relevante të pushtetit lokal dhe qendror, për të definuar pronësinë e stacionit dhe anekseve përcjellëse,

por fatkeqësisht për këto kërkesa nuk kemi pranuar asnjë përgjigje pozitive për vite të tëra. Ministri i MPB-së krahas mirënjohjes dhe falënderimit për punën e zyrtarëve policorë pranë këtij stacioni që e bëjnë në të mirë të qytetarëve, u zotua dhe premtoj se do të ngrisë problemin logjistik-infrastrukturor në të gjitha instancat relevante, me qëllim që PK-së t'i ndahet një hapësirë e nevojshme për ndërtim të një objekti policor i cili plotëson kushtet sipas standardeve.





Në ditën e shënimit të 18 vjetorit të themelimit të Policisë së Kosovës, 17 majorë avancohen në gradën nënkolonel

Policia e Kosovës me 6 shtator 2017 ka shënuar përvjetorin e 18-të të themelimit të saj në një ceremoni solemne të mbajtur në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në Prishtinë.

Në këtë ceremoni morën pjesë përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës, përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare të sigurisë, përfaqësues nga ICITAP-i, OSBE-ja, zyrtarë të Policisë e të pranishëm të tjerë.

Lidhur me të arriturat dhe rezultatet e Policisë së Kosovës dhe sfidat e përgjithshme që ka pasur ky institucion gjatë këtyre 18 viteve të zhvillimit të saj dhe profesionalizimit, nga një fjalë rasti mbajtën drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Shpend Maxhuni si dhe ministri në detyrë i Punëve të Brendshme z. Skender Hyseni.

Me rastin e shënimit të këtij përvjetori për pjesëtarët e Policisë së Kosovës të cilët janë dalluar me meritat e tyre në kryerjen e detyrës janë ndarë: 6 medalje për shpëtim jete, 1 medalje për

shërbim të dalluar, 15 medalje policore për lëvdim, 24 lëvdata dhe 8 mirënjohje. Po ashtu gjatë ceremonisë janë graduar edhe 17 (shtatëmbëdhjetë) zyrtarë nga grada major në gradën nënkolonel. Policia e Kosovës mbetet e

përkushtuar në përmbushjen e vizionit dhe misionit të saj, në zbatimin e ligjit dhe Kushtetutës së vendit, garantimin e rendit dhe sigurisë, në mënyrë që të ofrojë një shërbim efikas policor dhe profesional ndaj të gjithë qytetarëve.



Policisë së Kosovës i shtohen edhe 27 majorë

Bazuar në nevojat operationale të Policisë së Kosovës për mbikëqyrës të nivelit të lartë ekzekutiv, me datën 26.10.2017, në një ceremoni të organizuar në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës në Prishtinë, janë graduar 27 zyrtarë policorë në gradën major.

Në ceremoninë e gradimit morën pjesë stafi i lartë drejtues i Policisë së Kosovës, në krye me drejtorin e Përgjithshëm z. Shpend Maxhuni si dhe ministrin e Punëve të Brendshme z. Flamur Sefaj.

Drejtori i Përgjithshëm i PK-së z. Maxhuni ndër të tjera tha se Policia e Kosovës është dëshmia kryesore që tregon nivelin profesional dhe përkushtimin e vazhdueshëm drejt fuqizimit të zbatimit të ligjit, me qëllim të shërbimit drejt qytetarëve si dhe ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike në vend. Ne do të punojmë së bashku, të vetëdijshëm që e ardhmja do të sjellë sfida të reja, rritja dhe kompleksiteti i të cilave do të ndryshojë vazhdimisht, por unë jam i bindur që çdo ditë ju do të përballeni me to, do t'i përmbushni ato me përkushtim dhe profesionalizëm, sepse arritjet



dhe sukseset do t'ju bëjnë më të fortë, theksoi z. Maxhuni.

Ndër të tjera z. Maxhuni zyrtarët policorë të graduar i ftoi që të tregohen personalisht përgjegjës dhe të përgjegjshëm për veprimet dhe obligimet e tyre, duke kryer të gjitha detyrat e ngarkuara me sukses, etikë dhe integritet. Ndërsa, ministri i MPB-së z. Sefaj tha se Policia e Kosovës me përkushtimin dhe punën e saj të vazhdueshme po dëshmon profesionalizëm të lartë, po tregon se është ndër institucionet më të rëndësishme të zbatimit të ligjit dhe ofrimit të sig-

urisë ndaj qytetarëve dhe vendit. Njëkohësisht ministri z. Sefaj i përgëzoi zyrtarët policorë për gradimin e tyre dhe uroi që të shkëlqejnë në punën e tyre ashtu siç po iu shkëlqejnë edhe gradat e tyre.

Gradimit të zyrtarëve policorë i ka paraprirë sukcesi që ata kanë treguar në testimet për gradën major dhe përfundimi me sukses i trajnimit "menaxhimi i lartë ekzekutiv" në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Zyrtarët policorë të graduar në gradën major do të shërbejnë nëpër pozita të ndryshme të Policisë së Kosovës.





Intervistë me togerin Bajram Shabani nga Sektor

Mbrojtësi: I nderuar z. Shabani, Drejtoria për Planifikim dhe Vlerësim Operacional (DPVO), në kuadër të së cilës punoni ju, ka një rol të rëndësishëm në PK, a mund të na thoni cilat janë detyrat konkrete me të cilat merret kjo drejtori?

Toger Bajram Shabani: Drejtoria për Planifikim dhe Vlerësim Operacional bën pjesë në Divizionin për Siguri Publike pranë Departamentit të Operacioneve në DPP. Shumica e angazhimeve dhe detyrave që kryhen në nivel të kësaj drejtorie janë nevojat menaxheriale të drejtorit të Operacioneve, drejtorit të Divizionit të Sigurisë Publike dedikuar drejtorive rajonale të Policisë, që kryesisht kanë të bëjnë me koordinime, detyra, udhëzime e planifikime operacionale të fushës së sigurisë së përgjithshme.

Sipas nevojave operacionale DPVO ka përgjegjësi që të bashkërendojë dhe të koordinojë veprimet policore edhe me departamentet, drejtoritë e njësi të tjera policore karshi pozicionimit të tyre përbrenda organizimit të Policisë, për siguri të përgjithshme dhe për planifikime operacionale në baza ditore, javore, mujore dhe vjetore.

Bashkërendimi dhe koordinimi i aktiviteteve të ndërsjella sipas nevojave bëhet edhe me institucione të tjera të vendit, si me Protokollin e



Toger Bajram SHABANI

SHEF I SEKTORIT PËR PLANIFIKIM PERMANENT

Shtetit, Presidencë, Kuvend, Qeveri, ministritë e ndryshme etj., po ashtu edhe me agjenci e organizata të tjera të sigurisë që funksionojnë në Republikën e Kosovës si: Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), Agjensioni i Kosovës për Inteligjencë (AKI), Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave (AME), Doganën e Kosovës, si dhe në situata speci-

fike edhe me EULEX-in dhe KFOR-in, gjithmonë duke bashkëpunuar përmes pikave të kontaktit që i kemi me ndërlihdësit e misioneve të tyre.

Drejtoria për Planifikim dhe Vlerësim Operacional (DPVO) zhvillon inspektime nëpër nivelin lokal rreth implementimit dhe respektimit të udhëzimeve të dhëna nga



ri për Planifikim Permanent në Policinë e Kosovës

drejtori i Divizionit të Sigurisë Publike apo edhe nga drejtori i Departamentit për Operacione përmes urdhrave operativë, shkresave dhe urdhërësive të ndryshme, rreth zbatimit dhe implementimit të objektivave strategjike dhe aktiviteteve tjera policore. Kjo drejtori në organogramin e brendshëm i ka tre sektorë të ndryshëm, të ndarë në bazë të specifikave të ndryshme të punës, që ndërlidhen me çështje dhe nevoja për rendin dhe sigurinë publike. Sektorët përbërës në nivel drejtorie janë: Sektori për Planifikim Permanent, Sektori për Planifikim Operacional dhe Sektori për Vlerësim Operacional.

Mbrojtësi: Me që një nga detyrat është edhe planifikimi i vizitave të personaliteteve të larta shtetërore, ku PK-ja ka për detyrë që të ofrojë siguri dhe përcjellje për VIP, si planifikohen dhe realizohen përcjelljet e eskortave dhe ofrimit të sigurisë?

Toger Bajram Shabani: Kur jemi tek angazhimet policore në ofrim të sigurimit dhe përcjelljes së VIP-ve, PK-ja ka Njësine për Mbrojtje të Afërt (NjMA) e cila funksionon në kuadër të Divizionit të Njësie Speciale (DNjS), pranë Departamentit të Operacioneve. Për angazhim të NjMA-së për përcjellje të VIP-ve vendorë ajo realizohet gjith-

një pas vlerësimit të rrezikut dhe kërcënimit nga Njësia për Vlerësim të Rrezikut dhe Kërcënimit e cila me strukture është po ashtu në DNJS. Pas pranimit të vlerësimit të rrezikshmërisë hartohen edhe plane/urdhëra operativë, në të cilët parashihen të gjitha veprimet operacionale të segmenteve të ndryshme të PK-së, të cilat angazhohen në ofrim të përcjelljes, sigurimit të VIP-së si dhe në ndërmarrjen e masave të sigurisë publike lidhur me mbarëvajtjen e vizitës që nga fillimi e deri në përfundim sipas agjendës së paraparë.

Mbrojtësi: Si qëndron bashkëpunimi me institucionet tjera të sigurisë vendore e ndërkombëtare?

Toger Bajram Shabani: Bashkëpunimi, bashkërendimi dhe koordinimi i aktiviteteve të ndërsjellës sipas nevojave operacionale bëhet edhe me institucione të tjera të vendit e po ashtu edhe me agjenci e organizata të tjera të sigurisë që funksionojnë në Republikën e Kosovës, si: Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), Agjensioni i Kosovës për Inteligjencë (AKI), Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave (AME) etj., si dhe në situata specifike edhe me EULEX-in dhe KFOR-in gjithmonë duke bashkëpunuar përmes pikave të kontaktit që i kemi me ndërlidhësit e mis-

ioneve të tyre. Bashkëpunimi është në nivelin e duhur dhe bashkërendimi i të gjitha aktiviteteve realizohet në një stad të shkëlqyeshëm.

Mbrojtësi: A hartohen urdhra operativë nga kjo drejtori (DPVO) edhe për drejtoritë tjera rajonale të Policisë, nëse po në të cilat raste?

Toger Bajram Shabani: Bazuar në udhëzuesin për hartim të planeve/urdhrave operativë dhe menaxhimin e operacioneve policore nga Departamenti i Operacioneve përmes Drejtorisë për Planifikim në DPP hartohen plane/urdhra operativë (UO) dhe procedohen tutje për zbatim tek drejtoritë rajonale. Në këta UO, organizimi i planifikimit operacional të niveleve të ndryshme të sigurisë, realizohet dhe koordinohet me përfshirje të burimeve nga niveli qendror dhe ai lokal si dhe me shtrirje të operacioneve në një apo më shumë drejtori rajonale të policisë. Për shembull kemi UO që procedohen për implementim, ku të përfshira janë më shumë se një DRP, si: përvjetori i Pavarësisë së Kosovës, vizita të personaliteteve të larta shtetërore, ku përveç DRP-ve në UO janë të përfshira edhe departamentet tjera të PK-së, si: Departamenti i Hetimeve, Policisë Kufitare, Shërbimeve Mbështetëse etj.

Aspekte teorike të trajtimit të sigurisë së përgjithshme dhe ndikimi ideologjik



Daut HOXHA

Siguria e përgjithshme çdo ditë e më tepër po konsiderohet si një sfidë për shoqëritë dhe institucionet përgjegjëse për siguri kudo në botë.

Mënyra e përballjes ndërmjet rivalëve, qofshin ata ideologjikë apo politikë, përfshin një gamë variabile të veprimeve që nganjëherë janë të paparashikueshme dhe vështirë të menaxhueshme, qoftë edhe për shtetet më të fuqishme të cilat kanë edhe mekanizma dhe agjenci mjaft të zhvilluara përt'u ballafaquar me rrezikun dhe që në vazhdimësi ndërmarrin masa proaktive dhe aktive në funksion të menaxhimit të sigurisë së përgjithshme. Kjo mund të potencohet pikërisht për faktin se krahas zhvillimit të teknologjisë janë krijuar edhe kushte dhe rrethana potencialisht më të favorshme për qasje dhe veprime më të koordinuara duke përfshirë edhe propagandimin në kohë dhe hapësirë optimale.

Efektet e veprimeve propaganduese si rezultat i shpërndarjes së shpejtë të informacioneve përmes kësaj teknologjie të avancuar që në raste të shumta ndërliiden edhe me ideologji ekstremiste, në një mënyrë arrijnë indoktrinimin në njërin anë dhe krijimin e panikut në anën tjetër, për grupe

shoqërore apo shoqërisë njerëzore në përgjithësi, ku jo rrallë krijojnë edhe konfuzion në aspektin e sigurisë.

Vendi ynë nuk ka shpëtuar pa u prekur nga zhvillime të tilla ku ideologji të ndryshme janë përplasur në përpjekje për të dominuar mbi njëra-tjetrën dhe se konfliktet e zhvilluara në botë kanë elektrizuar edhe elemente të caktuara në vendin tonë për t'u involvuar në nxitje dhe mbështetje të organizatave të ndryshme (edhe terroriste), gjoja në përhapjen e ideologjive apo kauzave të ndryshme. Shoqëria jonë kosovare dhe institucionet shtetërore të sigurisë në Republikën e Kosovës me vëmendje kanë përcjellë situatën e sigurisë, duke pasur një bashkëpunim aktiv dhe rol reciprok në parandalimin dhe reduktimin e ndikimit të përhapjes së ideologjive ekstremiste si dhe izolimin e elementeve propagandistike të tyre. Toleranca dhe bashkëpunimi i qytetarëve tanë me institucionet relevante është një avantazh që vendin tonë e rangon si të suksesshëm në luftën kundër terrorizmit. Policia e Kosovës ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në adresimin e kësaj problematike dhe aktivizimin e të gjithë akterëve tjerë në funksion të përmirësimit të gjendjes së sigurisë së përgjithshme. Kosova si edhe vendet tjera nuk mund të jetë immune ndaj veprimeve të paparashikueshme terroriste që mund të ndodhin, megjithatë vendi ynë ka arritur që të menaxhojë dhe të mbajë nën kontroll elemente të cilat janë vlerësuar se janë potencialisht të ndërlidhura me individë apo celula terroriste dhe bazuar në situata evidente janë shënuar edhe raste konkrete të parandalimit të veprimeve të tilla që mund të kenë rezultuar edhe

Shoqëria jonë kosovare dhe institucionet shtetërore të sigurisë në Republikën e Kosovës me vëmendje kanë përcjellë situatën e sigurisë, duke pasur një bashkëpunim aktiv dhe rol reciprok në parandalimin dhe reduktimin e ndikimit të përhapjes së ideologjive ekstremiste si dhe izolimin e elementeve propagandistike të tyre. Toleranca dhe bashkëpunimi i qytetarëve tanë me institucionet relevante është një avantazh që vendin tonë e rangon si të suksesshëm në luftën kundër terrorizmit

me pasoja të paparashikueshme.

Megjithëse Kosova këto vitet e fundit ka kaluar nëpër disa procese fragjile ekonomike, politike dhe sociale, Policia e Kosovës bazuar në fushëveprimin e saj ligjor ka ndërmarrë në vazhdimësi masa operacionale në mënyrë profesionale, për të mbajtur rendin dhe për të garantuar një siguri në vend, si dhe funksionim normal të institucioneve shtetërore. Përveç garantimit të funksionimit institucional, përmes një pune profesionale dhe transparence aktive, qoftë me shoqërinë dhe mediat në përgjithësi, është arritur edhe krijimi i një besimi të ndërsjellë, gjë që Policinë e Kosovës e bën të rangohet si një nga institucionet e sigurisë, jo vetëm më transparenten, por edhe më të besueshmen në këtë pjesë të rajonit.



Policia e Kosovës realizon aktivitete shtesë me qëllim të ngritjes së sigurisë në trafik

Policia e Kosovës, përveç aktiviteteve të tjera të shumta, gjatë muajit shtator, ka ndërmarrë aktivitete shtesë në ofrimin e sigurisë së fëmijëve, gjegjësisht nxënësve, duke realizuar ligjërata nëpër shkolla dhe kopshte të fëmijëve, si dhe në mbajtjen e pikave të kontrollit në afërsi të shkollave. E gjithë kjo me qëllim të krijimit dhe vetëdijesimit sa më të madh për njohuri dhe respektim të rregullave të trafikut rrugor. Bazuar në të dhënat e aksidenteve

fatale që kanë ndodhur në muajin shtator 2017, prej tetë (8) aksidenteve fatale, jetën e kanë humbur dhjetë (10) persona, prej tyre pesë (5) shoferë, tre (3) pasagjerë dhe dy (2) këmbësorë. Vlen të ceket se asnjë prej personave që kanë humbur jetën në trafik për këtë periudhë kohore, nuk ka qenë nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç. Duke iu referuar numrit të nxënësve dhe lëvizjes së tyre nga shtëpia në shkollë apo nga shkolla në shtëpi,



Policia e Kosovës apelon: që të rritet vigjilenca, të shtohet kujdesi i prindërve dhe i nxënësve gjatë pjesëmarrjes në trafikun rrugor. Në veçanti të shtohet kujdesi nga drejtuesit e automjeteve që të respektojnë të gjitha rregullat që dalin nga ligji mbi trafikun rrugor, për të garantuar një siguri më të madhe dhe për shmangie të aksidenteve nëpër rrugë.

Në të kundërtën Policia e Kosovës, për të gjithë pjesëmarrësit në trafikun rrugor, që bien ndesh me rregullat e trafikut, do të vazhdojë të aplikojë ndërmarrjen e masave ligjore dhe do të ketë zero tolerancë.





POLICIA E KOSOVËS POLICIJA KOSOVA KOSOVO POLICE





192

НСУ-НИКА-ЖКА

НСУ-НИКА-ЖКА

Qershor/ Juni/ June

FIRST ADDITION	TARGET CALCULUS	INTERMEDIATE ALGEBRA	ALGEBRA TRIGONOMETRY	PRECALCULUS TRIGONOMETRY	STATISTICS	PHYSICS	SCIENCE
				1	2	3	
4	5	6	7	8	9	10	
11	12	13	14	15	16	17	
18	19	20	21	22	23	24	
25	26	27	28	29	30		

Editor/ Decembar/ December

PERSON	DATE ADMITTED	DATE EXPIRED	NUMBER OF VISITS	TYPE OF VISIT	PERSON VISITED	DATE VISITED	TYPE OF VISIT	PERSON VISITED
							1	2
3	4	5	6	7	8	9		
10	11	12	13	14	15	16		
17	18	19	20	21	22	23		
24	25	26	27	28	29	30		
31								

ROLI I TË RINJVE NË IDENTIFIKIMIN DHE PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM QË SHPIE NË TERRORIZËM



Me avancimin dhe dinamizmin e jetës së njerëzve në mbarë botën dhe nevojat personale dhe shoqërore në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë janë shtuar dhe kanë ndryshuar jashtëzakonisht shumë. Meqë ndryshimi dhe përparimi i mënyrave të kryerjes dhe trendit të krimit, ndryshimi i mënyrës dhe zhvillimit të dinamikës së qarkullimit të njerëzve dhe mallrave, avancimi i shpejtë dhe përdorimi i madh i teknologjisë, vështirësitë e paraqitura në të kaluarën në aspektin e sigurisë në bashkësi kërkon një qasje pragmatike të organeve të zbatimit të ligjit. Një ndër nevojat elementare për zhvillimin e shoqërive demokratike padyshim është avancimi apo deri në një masë përsosmëria e sistemit të drejtësisë përmes ofrimit të shërbimeve të besueshme dhe cilësore për anëtarët e bashkësisë. Duke marrë për bazë hulumtime të ndryshme në tërë botën, të realizuara në fusha të ndryshme të dukurive negative, e kryesisht në fushën e identifikimit, parandalimit dhe luftimit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, është evidente se nuk mjafton vetëm trajtimi i terrorizmit përmes qasjes re-aktive apo represive kundrejt personave të dyshuar me prirje radikale dhe potencialisht me manifestim të

dhunës, por rol të veçantë dhe mjaft të rëndësishëm paraqet edhe qasja pro-aktive apo qasja e butë ndaj kësaj dukurie. Realisht, trajtimi adekuat dhe me seriozitet i qasjes pro-aktive në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, që potencialisht shpie në terrorizëm, është një qasje që ka rezultate afatgjata dhe parandalon përhapjen e ideologjive ekstreme tek popullata në përgjithësi.

Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë, respektivisht Sektori për Parandalim të Dhunës dhe Delikuençës së të Miturve, në bashkëpunim me Drejtorinë Kundër Terrorizmit, respektivisht Sektorin për Parandalim, duke u bazuar në Strategjinë dhe Planin e Veprimit 2017-2021 "Policimit në bashkësi" respektivisht objektivat strategjike I, II dhe III, ka për qëllim kryesor që të shërbejë në ngritjen e vetëdijes së nxënësve rreth konceptit të policimit në bashkësi dhe rolin e tyre në identifikimin dhe parandalimin e terrorizmit në përgjithësi.

Për më tepër, organizimi i këtij kampi rinor është bërë me qëllim të ngritjes së vetëdijes së nxënësve rreth rolit të tyre, në identifikimin dhe parandalimin potencial të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, do të kontribuojë

në shkëmbimin reciprok të informatave në mes të bashkësisë, respektivisht të rinjve dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit.

Në këtë kamp rinor kanë marrë pjesë nxënës, personel arsimor, përfaqësues nga shoqëria civile nga ShFMU "Qamil Batalli" dhe ShFMU "Pavarësia" nga Prishtina, ShML "Zenel Hajdini" nga Gjlani, ShML "Vëllezërit Frashëri" nga Deçani dhe ShML "Kuvendi i Arbërit" nga Ferizaj. Zyrtarë policorë profesionistë në fusha specifike të cilët kanë ligjëruar për temat, siç janë dhuna në shkollë, delikuenca e të miturve, keqpërdorimi i teknologjisë informative dhe rrjeteve sociale të komunikimit, parandalimi i pasojave nga përdorimi i substancave narkotike dhe parandalimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm. Gjatë këtij kampi rinor janë zhvilluar aktivitete të ndryshme nga fëmijët në grupe të cilat kanë shpalosur idetë dhe kreativitetin e tyre rreth asaj se si të avancohet bashkëpunimi i sigurtë në mes të rinjve dhe Policisë, si të identifikohen personat potencialisht të radikalizuar dhe përpjekjet potenciale të të rinjve për de-radikalizimin potencial të personave të radikalizuar.

Përgatiti: Mentor ÇAKOLLI

PËR HERË TË PARË POLICIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS ORGANIZON PROGRAM FESTIV ME FËMIJËT, PËR TË SHËNUAR 1 QERSHORIN, DITËN NDËRKOMBËTARE TË FËMIJËVE

1 Qershori është dita ndërkombëtare e fëmijëve. Fëmijët e të gjitha moshave kërkojnë që sot të jenë të lumtur dhe ta festojnë këtë ditë me prindër dhe lumturi e harmoni. Kjo ditë është kthyer jo vetëm në një ditë festive, por edhe në një ditë sensibilizimi, për t'i thënë jo dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve. Është dita kur vetë fëmijët ngrenë zërin për të drejtat e tyre, por në ndryshim nga të rriturit, protesta e tyre bëhet me lojëra festive.

1 Qershori e ka origjinën nga Shtetet e Bashkuara dhe Kina, por nuk ka të bëjë me komunizmin. Në vitin 1925 konsulli i përgjithshëm kinez në San Francisko mbledhi së bashku një numër të konsiderueshëm fëmijësh jetimë kinezë të celebronin në festivalin e "Anijes së Dragoit". Shumë vende të botës e kanë pranuar atë si festën ndërkombëtare të fëmijëve dhe realizojnë festime të cilat kanë si qëllim të rrisin vëmendjen në drejtim të mirëqenies së tyre.

Duke u bazuar në objektivin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2017-2021 "Policimi në Bashkësi" për ngritjen e sigurisë në shkollë; duke u bazuar në misionin dhe vizionin e Policisë së Kosovës në aspektin vetëdijesues dhe parandalues; me qëllim të ngritjes dhe avancimit të shërbimeve të saj në fushën e parandalimit dhe ngritjes së bashkëpunimit me qytetarë të Republikës së Kosovës; me qëllim të vetëdijesimit të komunitetit të prindërve dhe mësimdhënësve për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve; me qëllim të informimit të fëmijëve rreth të drejtave dhe obligimeve të tyre



në shoqëri, Drejtoria e Policisë në Bashkësi përmes Sektorit për Parandalim të Krimit dhe Delikuençës së të Miturve, në bashkëpunim dhe mbështetje nga programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP/KSSP/PVE) dhe në bashkërendim të aktivitetit me Kuvendin Komunal të Prishtinës, ka organizuar këtë aktivitet për të shënuar ditën ndërkombëtare të fëmijëve. Në këtë aktivitet policor kanë marrë pjesë njësi të ndryshme të Policisë, siç janë: Njësia Speciale Operative, Njësia e Patrullës, Njësia e Motoristëve, Njësia e Biçiklistëve dhe Njësia K9. Gjithashtu, gjatë këtij aktiviteti nga zyrtarë të Policisë janë shpërndarë broshura të ndryshme vetëdijesuese, të cilat kanë

trajtuar tema të ndryshme, me interes jo vetëm për fëmijët por edhe për komunitetin e prindërve sa i përket aspektit të sigurisë. Policia e Kosovës në kuadër të misionit dhe vizionit të saj për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ruajtjen e pronës dhe jetës së qytetarëve prioritet të veçantë i jep edhe fushës së parandalimit të dukurive negative dhe krimeve të llojeve të ndryshme. Për më tepër, Policia e Kosovës angazhohet maksimalisht që të vetëdijesojë anëtarët e bashkësisë por edhe vetë fëmijët, në veçanti, që të mbrojnë të drejtat dhe të promovojnë ato. Fatkeqësisht, përkundër angazhimeve të shumta të Policisë së Kosovës ende mund të ketë raste kur fëmijët janë shënjestër e dhunës dhe detyrimit për punë të rënda apo punë të cilat ndalohen dhe sanksionohen me ligj. Në këtë kontekst, jo rrallëherë kemi raste kur edhe vetë prindërit me vetëdije shkelin në mënyrë flagrante të drejtat e fëmijëve të tyre apo fëmijëve të tjerë. Policia e Kosovës përmes aktiviteteve vetëdijesuese bën përpjekje që të ngritë vetëdijen e anëtarëve të bashkësisë në përgjithësi, që të parandalojnë rastet e tilla të abuzimit dhe keqpërdorimit të fëmijëve, duke qenë pjesë e zgjidhjes së problemit përmes raportimit me kohë të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve, shkelje këto të cilat ende mund të jenë në fazën filluese dhe që pasojat për fëmijën në këtë rast mund të ri-kurohen apo të mënjanohen tërësisht.

Përgatiti: Mentor CAKOLLI



PUNA DHE SHKATHTËSITË E VEÇANTA TË NJË PERSONI TË VEÇANTË

Quhem Sanije Hargaja e lindur në fshatin Lajthishtë të komunës së Obiliqit. Shkollën fillore e kam përfunduar në Obiliq, kurse të mesmen e vazhdova në Shkollën Ekonomike në Prishtinë. Gjithnjë mendoja të bëhesha një punëtore e dalluar dhe me këtë vullnet u përkushtohesha mësimëve në shkollë.

Jam e martuar dhe me familjen time jetoj në fshatin Milloshevë.

Kam dy fëmijë të cilët vazhdojnë shkollimin, njëri është student kurse tjetri është në vitin e fundit të shkollës së mesme.

Kam qenë e privilegjuar kur në vitin 2006 u punësova në Policinë e Kosovës, atëherë si nëpunëse në DSORVP në DPP. Pas tri vjetësh kalova në Drejtorinë e Shërbimeve Shëndetësore në pozitën asistente administrative, ku vazhdova të shërbej tri vjet të tjera për të vazhduar në Njësinë Përkrahëse të Personelit, ku edhe jam tani.

Pozita ime aktuale është asistente administrative, në të cilën pozitë mundohem të japë maksimumin për kryerjen e punëve që më takojnë.

Detyrat e mia të punës me të cilat merrem çdo ditë janë: përpilimi i raporteve, mirëmbajtja e dosjeve, regjistrimi i pushimeve të llojeve të ndryshme (vjetore, me kompensim dhe pushime të tjera), lëshimi i vendimeve të përvojës së punës, pranoj thirrje telefonike dhe kërkesa të ndryshme të punonjësve bazuar në rregulloren e PK-së, po ashtu edhe në mungesë të shefit edhe punë të tjera që i përkasin atij.

Ndjehem shumë mirë kur mund t'i zgjidh çështjet që palët kërkojnë, ku edhe ndahen të kënaqur.

Pozita asistent administrativ në PK



për mua domethënë shumë sepse mendoj që më jepet mundësia për kryerjen e shërbimeve të ndryshme dhe fitimin e njohurive të reja të punës. E kam gjetur veten mirë dhe me këtë punë mendoj se po e formësoj personalitetin tim.

E falënderoj gjithë Policinë e Kosovës pa dallim grade apo pozite që më kanë inkuadruar shumë mirë dhe më kanë bërë krenare të jem pjesë e një institucioni siç është ky dhe më kanë dhënë motiv për punë edhe pse jam person me aftësi të kufizuara.

Në vitin 2005 pata kënaqësinë edhe të udhëtoj jashtë vendit në një garë sportive.

Në Rambuje të Francës, në lojërat

paraolimpike të kategorisë së personave me aftësi të kufizuara pata fatin t'i fitoj tri medalje olimpike, një të artë dhe dy të argjendta. Kjo garë më forcoi dhe më dha vetëbesim.

Dua të theksoj se ndjehem mjaft mirë me kolegë të tjerë, të cilët kanë respekt jashtëzakonisht të madh në raport me mua dhe mirësjellja në orarin e punës mua më ka dhënë kurajë dhe vullnet të mirë. Pozitiviteti më ka dhënë edhe mua mirësinë dhe në vendin e punës ndjehem si në shtëpinë time.

U jam mirënjohëse të gjithëve që më rrethojnë.

Përgatiti: Merita Canolli - Gashi



PROFESIONISTJA - POLICJA NËNË, SFIDË QË KËRKON MUND DHE PËRKUSHTIM

Të jesh nënë do të thotë të jesh një kandil që çdo rrugë ndriçon, edhe përkundër përpelitjeve të vazhdueshme e të pandalura për t'i arritur të gjitha caqet.

Siç edhe dihet NËNA është shtylla e një familjeje, kreu më i fortë në një kulm. Ajo ka pasion familjen e shendosh, e ka obligim mirëmbajtjen e çdo gjëje rreth saj me durim, por ka edhe një profesion – një punë të cilën duhet ta mbaj si profesioniste.

Profesionet e nënave janë te larmishme, disa kërkojnë shumë sfida e përgjegjësi, disa janë paksa më të lehta por profesioni 'NËNË' ua mund të gjitha profesioneve tjera. "Shkolla nënë" është një udhëzues që të jep leksione trajnuese për secilin profesion nga pak e që secili profesion ushtrohet me dashuri e përkushtim nga zemra.

Një nënë e rrethuar nga obligimet ditore është nën presion kohe e me mundin e pakursyer gjithsesi duhet t'ia dalë që me sukses t'i mbarojë të gjitha punët.

Profesionistja 'Nënë' që ka edhe emrin

POLICE bëhet edhe më e veçantë në obligime, ajo mban ngjitur për veten e saj edhe një 'fëmij' vetëmbrojtës e mbrojtës të të tjerëve, armën ngjitur për brezi. Ajo mban përgjegjësinë përveç familjes edhe të një populli të të tërë. Ajo ka të veshur petkun e MBROJTËSES. Ajo është e thirrur të jetë e zgjuar gjithmonë. Ajo duhet të jetë shembull i familjes dhe i një shoqërie të gjerë, është një nënë e quajtur POLICE.

Brenda saj fshihen të gjitha, në të e gjejmë një punëtoreshë udhëheqëse që din të punojë me prioritete e me përkushtim.

Ajo e drejton me sukses së pari "institucionin" e quajtur 'FAMILJE' e fare pa brenga ajo mund ta udhëheq çfarëdo institucioni shtetëror sepse përvoja e udhëheqëses së familjes gjithnjë do të na sillte suksese edhe aty ku e kërkon profesioni. Gërshtimi i përvojave nga jeta sociale –familjare dhe profesionale jep fryte të larta. Ajo është liderë në çdo fushë, është mbretëreshë e çdo lëmie. Ajo është SUPERMENAXHERE! Ajo di t'i respektojë rregullat (edhe

pse përvojat e një nëne shpesh të shtyjnë t'i shqelmosh ato), ajo din ta ruaj qetësinë me durimin e vetëpërmbytjes, ajo din të falë duke u arsyetuar në rregullat e pashkruara të përvojës jetësore, ajo është udhërrëfyes që zgjidh çdo nyje.

Ajo ka virtyte të larta udhëheqëse në shtëpi e në punë, ajo mban barrën e shumë problemeve shoqërore sepse i njeh mirë ato, sepse është nënë e me profesion police. Ajo gjendet përkrah meshkujve në situata dramatike në punë, ajo ia del të punojë edhe në ndërrimin e tretë (të natës), të dalë në ballë të protestave ditën dhe të rris fëmijë të shëndosh të edukuar e të ndershëm gjatë gjithë jetës. Ajo është pishtarë që ndriçon kur ka mungesë drite, kur mungon shpresa, kur problemet shfaqen, kur duhet mbrojtje, kur duhet mirëqenie, kur nevojitet paqe. E kush do ta bënte më me përgjegjësi e ndjeshmëri në raste të caktuara profesionin e një policeje më mirë se mësimet e përvojës së një nëne? Atë mund ta quajmë edhe heroina jonë, "POLICJA NËNË".

Merita Canolli-GASHI



ICITAP-I AMERIKAN NË BASHKËPUNIM ME “NORTHWESTERN UNIVERSITY, CENTER FOR PUBLIC SAFETY” MBËSHTETET POLICINË E KOSOVËS

Policia e Kosovës me partnerët e saj ndërkombëtarë, në veçanti ata amerikanë, si mbështetës të vazhdueshëm në funksion të ngritjes profesionale dhe përgatitjes së stafit policor, gjatë këtij viti ka realizuar trajnime mjaft të rëndësishme.

ICITAP-i amerikan në bashkëpunim me “Northwestern University, Center for Public Safety” dhe Policinë e Kosovës, nga data 20 shkurt deri më 12 maj 2017, me ligjërues me përvojë, profesorë me renome të këtij universiteti ka realizuar trajnimin dhjetë javor “Shkolla e stafit policor dhe komandues” në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Sjellja organizative, lidhshipi, vendimmarrja dhe alokimi i burimeve njerëzore ishin ndër lëndët të cilat u ligjëruan dhe u trajtuan në mënyrë mjaft profesionale nga ligjëruesit amerikanë.

Pas përfundimit të trajnimit, ku pjesëmarrës ishin gjithsej tridhjetë e nëntë (39) zyrtarë nga Policia e Kosovës, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Forca e Sigurisë së Kosovës, Inspektorati



Policor si dhe Dogana e Kosovës, u organizuar ceremonia e diplomimit me ç’rast morën pjesë ambasadori amerikan në Kosovë z. Greg Delawie, përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme, AKSP-ja, Doganat e Kosovës, Policia e Kosovës, drejtori i Qendrës për Siguri Publike i Universitetit Northwestern z. David Bradford, menaxheri i programit ICITAP

për Kosovë si dhe përfaqësues të universitetit “Northwestern”.

Nga të pranishmit ky trajnim u vlerësua lart në ngritjen e nivelit profesional dhe përfitimit të njohurive të shkëlqyera nga fusha e sigurisë publike.

Përderisa, në fund të ceremonisë u shpërndanë certifikatat lidhur me përfundimin e suksesshëm të këtij trajnimi.

VITAMINA 'D' PJESË THELBËSORE E SHËNDETIT



Dr. Lindita Kajtazi
Interniste-Endokrinologe

Vitamina 'D' është një vitaminë mjaft me rëndësi dhe unike për organizmin e njeriut. Ajo funksionon si prohormone, ku nën veprimin e rrezeve të diellit, trupi mund ta sintetizojë atë, do të thotë nga rrezet e diellit ultra-violetë B. Prandaj, preferohet 15-20 minuta rrezitje në diell gjatë një dite, pa shfrytëzimin e kremit për mbrojtje nga dielli, që të kemi mundësi të sigurojmë sasi të mjaftueshme të vitaminës D. Kjo vitaminë sigurohet edhe përmes ushqimit, me theks të veçantë ka rëndësi përdorimi i vajit të peshkut, produktet e qumështit etj.

Funksioni kryesor biologjik i vitaminës D qëndron në mbajtjen e nivelit normal të kalciumit dhe fosforit në gjak, duke ndikuar në absorbimin e kalciumit dhe pastaj duke rezultuar me eshtra të forta, në sistemin imunitar për shkak të vetisë baktericide të saj dhe në parandalimin e disa sëmundjeve, përfshirë edhe diabetin, krizat astmatike, sëmundjet malinje, zhvillimin e mbarë të fetusit (këtu dhe qëndron rëndësia që një grua shtatzënë të ketë kujdes për koncentrimin në përfitimin e kësaj vitamine) etj.

Mungesa e vitaminës D është bërë një sëmundje e përhapur në shkallë të gjerë. Përcillet me mungesë kronike të energjisë, plogështi, mungesë të forcës imunitare, dhimbje në eshtra, thyerje të shpeshta të eshtrave, osteoporozë që rezulton me dobësinë muskulare dhe eshtra të dobët, depresion, humbje të kujtesës (tek të moshuarit), nxit rakit dhe deformitete në skelet (tek fëmijët), dhimbje në muskuj etj...


Mungesa e vitaminës D vjen si rezultat i punës në ambient të mbyllur, si: në zyrë, lokale të ndryshme, punës gjatë ndërrimeve të natës, ushqimit joadekuat, tek sëmundjet kur veshka nuk mund ta shndërrojë vitaminën D në formë aktive, mbipeshës etj.

Rrezet e diellit janë burimi i parë i vitaminës D, posaçërisht gjatë stinës së dimrit kur dita është më e shkurtër dhe mundësitë për dalje zvogëlohen.

Të gjitha këto pasoja nga mungesa e kësaj vitamine vijnë siç e përmendëm nga mungesa e rrezeve të diellit e sigurisht se vlen të përmendim se rrezik për këtë kanë zyrtarët që punojnë në ambiente të mbyllura brenda zyrave 8 orë dhe gjithsesi se pasojat shfaqin rrezik për shëndetin.

Ju rekomandojmë të matet niveli i vitaminës D në gjak, që të kuptojmë a kemi mungesë të vitaminës D, në mënyrë që me kohë t'i evitojmë pasojat e mungesës së kësaj vitamine dhe mungesën ta përfitojmë përmes

të ushqyerit të drejtë dhe marrjes së suplementeve me kohë (vetëm me dozimin e mjekut).



OPERACIONE

DISA NGA OPERACIONET E SUKSESSHME

NË FOKUS TË ANGAZHIMEVE POLICORE ËSHTË EDHE IDENTIFIKIMI I FËMIJËVE LËMOSHËKËRKUES SI VIKTIMA TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT DHE LUFTIMI I DUKURISË SË KEQPËRDORIMIT TË FËMIJËVE NË PËRGJITHËSI

Dukuria e kërkim lëmoshës është një fenomen shqetësues dhe kjo dukuri mbetet e pranishme. Çdo ditë vërehen fëmijë si dhe të rritur duke kërkuar lëmoshë nëpër rrugë, udhëkryqe, kafiteri e lokale të ndryshme. Këta persona, sidomos fëmijët, derisa qëndrojnë në rrugë me orë të tëra të shtrirë, duke lëvizur apo edhe duke pastruar parafango të veturave, jeta e tyre është në rrezik gjithnjë në trafik rrugor, këta fëmijë duke bredhur rrugëve deri në orët e vona të natës mund të jenë viktimat potenciale të krimit por edhe të trafikimit.

Sipas ligjit për rend dhe siguri publike edhe dukuria e kërkim lëmoshës është kundërvajtje.

Policia e Kosovës, respektivisht njësitet kompetente me zyrtarët e saj, fokus të veçantë i kushton mbrojtjes së fëmijëve në situatë rruge, sepse fëmijët mund të jenë viktimat potenciale të keqpërdorimit, krimit dhe trafikimit, gjë që duhet të jetë prioritet edhe i institucioneve tjera relevante që merren me trajtimin e kësaj problematike. Policia përveç masave të koordinuara me akterët tjerë, aty ku ka elemente të veprave penale, duke përfshirë edhe trafikimin me njerëz apo krimin e organizuar, ndërmerr veprime hetimore dhe operacionale dhe për çdo rast opinioni dhe mediat njoftohen në vazhdimësi.

Në një rast, Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore ka hartuar planin operativ "Identifikimi i fëmijëve lëmoshëkërkues si viktimat të mundshme të trafikimit", i cili është zbatuar në gjithë territorin e vendit me 5 korrik 2017.

Implementimi i këtij operacioni policor ka pasur qëllim identifikimin e viktimave të trafikimit dhe zvogëlimin e pranisë së fëmijëve lëmoshëkërkues në rrugë.

Plani operativ është mbështetur edhe nga akterë tjerë relevantë, si: gjykatat dhe prokuroritë e rajoneve përkatëse, Qendra për Punë Sociale, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj e PK-së.

Gjatë zbatimit të këtij plani operativ janë kryer këto veprime:

- Janë identifikuar tridhjetë e dy fëmijë lëmoshëkërkues (20 shtetas të Kosovës dhe 12 shtetas të Shqipërisë),

- Janë identifikuar njëzet e një lëmoshëkërkues të moshës së rritur (15 shtetas të Kosovës dhe 6 shtetas të Shqipërisë),

- Janë arrestuar katër persona nën dyshimin e përfshirjes në veprën penale 'keqtrajtim apo braktisje e fëmijës' dhe janë ngritur njëmbëdhjetë kallëzime penale mbështetur në po këtë veprë.

Shtetasit e huaj janë dërguar për procedurë të mëtejshme në Drejtorinë për Migrimi dhe të Huaj që të vazhdojnë me veprime tjera bazuar në Ligjin për të huaj.

POLICIA E KOSOVËS ME DEA-N AMERIKANE REALIZOJNË OPERACION TË PËRBASHKËT



Policia e Kosovës, Divizioni Kundër Krimit të Organizuar, konkretisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë (DHTN) në bashkëpunim me DEA-n amerikane, pas hetimeve disa mujore, ka realizuar tri operacione policore. Hetimet janë zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarët amerikanë në mënyrë paralele në të dyja vendet. Dy operacione janë realizuar në Republikën e Kosovës (rajoni i Pejës) dhe një në New York. Në mbështetje të realizimit të operacioneve kanë qenë pjesëmarrës: Drejtoria e Njërive Speciale të PK-së, Drejtoria për Mbështetje të Hetimeve, Drejtoria e Forenzikës dhe njësi të tjera policore në koordinim me Prokurorinë Speciale dhe gjykatën kompetente.

Operacioni i parë është realizuar me 18 qershor 2017 rreth orës 18:30, ndërsa operacioni i dytë është realizuar me 27 qershor 2017 rreth orës 19:45 në Klinë. Operacionet kanë rezultuar me arrestimin e katër (4) personave në Kosovë, gjashtë (6) personave në New York si dhe janë konfiskuar armë dhe prova të tjera materiale.

Armët dhe dëshmitë tjera të konfiskuara gjatë operacionit:

- 15 armë automatike AK-47
- 120 fishekë, 7.62 mm
- 1 anti-tank (zolla)
- 1 pistoletë
- 1 pushkë ajrore
- 63000 € (gjashtëdhjetë e tre mijë euro)
- 2 vetura
- 4 telefona celularë

Me urdhër të prokurorisë kompetente personat e dyshuar janë dërguar në qendrën e mbajtjes për procedura të mëtejme ligjore.

POLICIA E KOSOVËS ME PLAN KONKRET "STOP DROGAVE NË SHKOLLA"



Policia e Kosovës, respektivisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë në funksion të realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të parapara me Strategjinë Kombëtare kundër drogave dhe legjislacionit në fuqi ne vazhdimësi gjatë këtij

viti dhe viteve që po lëm pas ka realizuar operacione të suksesshme në parandalimin dhe luftimin trafikimit me narkotik.

Gjatë operacioneve policore janë konfiskuar sasi e konsiderueshme e substancave të dyshuara narkotike, janë arrestuar numer i madh i personave të dyshuar si dhe shpartalluar grupe kriminale, njoftime që kemi bërë publike çdoherë përmes komunikatave për shtyp.

Policia në bashkpunim edhe me autoritetet tjera relevante në vazhdimësi po punon për parandalimin e rasteve të abuzimit me substanca narkotike, megjithatë në aspektin ligjor do të ndërmirren masa të ashpra ligjore ndaj të gjithë atyre që janë të involvuar në trafikim me substanca narkotike dhe vepra tjera të kundralegjishme që rrezikojnë shëndetin e të rinjëve tanë.

Një plan i veçantë operacional ka filluar të implementohet në gjithë vendin, sipas Urdhrit Operativ "Stop drogave në shkolla" ku janë realizuar dhe po realizohen aktivitete

policore si në fushën e parandalimit po ashtu edhe në fushën operacionale.

Në fushën e parandalimit janë realizuar vizita dhe kontakte me personelin e shkollës, në bashkëpunim me Qendrën e Mjekësisë familjare janë mbajtur ligjëratat, janë shpërndarë fletushka dhe janë angazhuar zyrtarë policor për patrullime rreth shkollave.

Ndërsa, në fushën operative janë kontrolluar persona të cilët kanë frekuentuar në zonën e sigurisë 300 m rreth shkollave, po ashtu janë kontrolluar vetura, lokale dhe vende tjera të dyshuara.

Për realizimin e aktiviteteve janë angazhuar zyrtarë policor nga, Drejtoria Rajonale të Policisë, Stacionet Policore, Drejtoria e Policimit në Bashkësi dhe Preventivë, Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë dhe Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë.

Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar në luftën kundër veprave kriminale duke përfshirë edhe të luftës ndaj trafikimit me narkotik.

ARRESTOHEN TETË (8) PERSONA TË DYSHUAR PËR 'MUNDËSIM NË PROSTITUCION DHE OFRIM TË LOKALEVE PËR PROSTITUCION', SI DHE 'MARRJE ME PROSTITUCION'

Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, në kuadër të veprimeve operativo-hetimore, me qëllim të parandalimit të krimit dhe luftimit të të gjitha dukurive negative, duke përfshirë edhe aktivitetet kriminale, gjatë muajit korrik 2017 me sukses ka realizuar disa operacione taktike operative.

Operacione policore janë realizuar nëpër rajone të ndryshme, si në Prishtinë, Ferizaj, Mitrovicë etj., ku si rezultat janë arrestuar tetë (8) persona të dyshuar të përfshirë në veprën penale 'mundësim në prostitucion dhe ofrim i lokaleve për prostitucion, veprën kundërvajtëse 'marrje me prostitucion' si dhe janë konfiskuar dëshmi materiale që mund të përdoren për procedim ligjor.

Këto veprime të kundërligjshme edhe si dukuri, përpos dëmtimit të imazhit të vendit, shtimit të pasigurisë në shoqëri, rritjes së problemeve familjare, ndikojnë edhe në shëndetin e qytetarëve, pasi që Policia gjatë zbatimit të operacioneve ka hasur edhe persona që kanë ushtruar veprimtarinë e 'marrjes me prostitucion dhe që kanë qenë të infektuar me sëmundje të ndryshme. Andaj, u bëhet apel qytetarëve që t'i shmangen veprimeve të tilla dhe për çdo rast të dyshuar të njoftojnë Policinë në mënyrë që organet kompetente të ndërmarrin masa

Arkivi qendror dhe misioni i arkivistit në Policinë e Kosovës



Ma. Sami SALLAHU
Shef i Sektorit të Arkivit Qendror

Sektori i Arkivit Qendror në Policinë e Kosovës, bazuar në strukturën organizative, funksionon në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme - Divizioni i Personelit dhe Administratës dhe ka dy njësi organizative, Njësinë e Arkivit dhe Njësinë e Regjistrimit, ku punonjësit kryejnë detyra dhe përgjegjësi të caktuara, të cilët ofrojnë shërbime efektive, duke u bazuar në përgatitjet profesionale.

Për funksionimin e këtij sektori është hartuar baza ligjore dhe rregulloret e brendshme në fushën e menaxhimit të dokumenteve zyrtare në harmoni me Ligjin për arkivat shtetërore, ligjet tjera relevante dhe standardet ndërkombëtare të arkivave. Ky sektor vepron duke zbatuar rregulloret e punës, Procedurat Standarde të Operimit, lista e kategorive të dokumenteve arkivore me afate të ruajtjes, rregulloren "Kodet administrative të klasifikimit të dokumenteve zyrtare" etj.

Arkivi dhe lënda e arkivit udhëhiqet edhe në bazë të rregullave unike dhe udhëzimeve profesionale të sektorit, ku përcaktohet metodologjia e punës në menaxhimin e dokumenteve dhe trajtimin e lëndës arkivore të Policisë deri të qasja apo shfrytëzimi i dokumenteve.

Përveç infrastrukturës ligjore, rregulloreve të brendshme, janë krijuar edhe kushte të përshtatshme në ambient



Arkivi Qendror i Policisë së Kosovës/DPP-Prishtinë

të sigurt me inventar modern, raftet e metaltë lëvizës (specialë), kamerat monitoruese në depon e arkivit si dhe pajisje tjera të nevojshme që bëjnë arkivin të jetë funksional në realizimin e objektivave të përcaktuara me planin e sektorit dhe planin vjetor të punës.

•Sektori i arkivi qendror, është sektor i vetëm në kuadër të DPP-së që merret me menaxhimin e dokumenteve zyrtare, mbledhjen dhe ruajtjen e fondit arkivor dhe është mirë i organizuar, ka metodologjinë e punës ku zhvillohen procedura konkrete të veprimit. Është vendi ku lënda arkivore pranohet, klasifikohet, evidencohet, ruhet, mbrohet dhe publikohet materiali arkivor, ku mundësohet shfrytëzimi për nevoja zyrtare, operative, hulumtime shkencore dhe punë profesionale si dhe çështje tjera me interes për institucionin. Lënda arkivore dhe dokumentet zyr-

tare të Policisë janë të mbrojtura me ligj dhe akte tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë.

•Lënda arkivore e Policisë, është tërësi e shkresave, dokumenteve të cilët kanë të bëjnë për të njëjtën çështje ose detyrë dhe përbëjnë një tërësi të veçantë. Lënda përbëhet prej dokumenteve të cilat janë të lidhura së bashku gjatë kryerjes së punëve në një detyrë ose në një lëmi të veprimtarisë. Po ashtu lënda arkivore është dëshmi e mënyrës se si është kryer një veprimtari, ndërsa vlera e saj është administrative dhe dëshmuese. Dokumentet nuk guxojnë të ndahen nga lënda të cilat e përbëjnë pjesën e përbashkët, jashtë atij konteksti dokumenti e humb kuptimin e vet dhe vlerën informative.

"Çdo dokument e ka vendin e vet në lëndë, ndërsa çdo lëndë është pjesë e fondit".

• Depoja e arkivit, është pjesë e rëndë-

sishme ku vendoset dhe ruhet lënda arkivore e Policisë në hapësirë adekuate më të gjitha parakushtet për një organizim efikas në ruajtjen dhe mbrojtjen e lëndës arkivore sipas standardeve bashkëkohore të arkivave.

•Njësia e Arkivit- nga kjo njësi bëhet vlerësimi (valorizimi) i dokumenteve ku përcaktohet vlera e dokumenteve zyrtare (afati i ruajtjes), analizohen, vlerësohen dhe afatizohen, bazuar në prejardhjen e dokumenteve, përmbajtjen, karakterin, ndjeshmërinë dhe elementet tjera.

Vlerësimi bëhet me qëllim që nga minimumi i dokumenteve të fitohet maksimumi i informatave.

•Njësia e Regjistrimit, kjo njësi bën menaxhimin e të gjitha shkresave zyrtare/evidentimin, ku evidencat themelore të punës janë librat e protokollit, plani i shenjave të klasifikimit (sipas strukturës organizative), regjistrimi i akteve, librat ndihmëse etj. Në këtë njësi po ashtu bëhet pranimi i shkresave (postes), hapja, kontrollimi dhe evidentimi i postës, evidentimi i shkresave, përpunimi administrativo-teknik i lëndëve, dërgimi i shkresave/postës brenda dhe jashtë Policisë, udhëheqja e afateve të punës dhe aktivitete të tjera në funksion të këtij shërbimi.

•Misioni i arkivistit dhe detyrat profesionale, detyrë parësore e arkivisteve që shërbejnë në arkivin qendror është ruajtja e tërësisë së dokumenteve që i besohen në përkujdesje të cilat i



vlerësojnë, regjistrojnë, selekcionojnë, ruajnë, mbrojnë etj., në pajtim me dispozitat ligjore të arkivistikës dhe standardet e përgjithshme të pranueshme për trajtimin e lëndëve në arkiv.

-Arkivistët i vlerësojnë dokumentet në mënyrë objektive, të paanshme, duke e mbështetur mendimin e tyre mbi bazat e njohjes së nevojave administrative dhe ligjore të sektorit.

-Arkivistët ruajnë besueshmërinë dhe integritetin e lëndës arkivore dhe u ofrojnë siguri dokumenteve gjatë përpunimit, mbrojtjes dhe shfrytëzimit, garantojnë që dokumentet të jenë të pranueshme dhe të kuptueshme.

-Angazhohen për veprime të drejta për ruajtjen e dokumenteve duke bashkëpunuar ngushtë me krijuesit e lëndës në aplikimin e formularëve standard të nevojshëm.

-Arkivistët janë përgjegjës për kujdesin dhe mbrojtjen e lëndës arkivore, respektimin e dispozitave ligjore të drejtat e shfrytëzuesve si dhe koordinohen me njësitet që dërgojnë lëndën në arkiv.

-Arkivistët u japin shpjegime shfrytëzuesve lidhur me të drejtat dhe kufiz-

imet gjatë shfrytëzimit dhe i zbatojnë ato në mënyrë të drejtë.

-Arkivistët e respektojnë lirinë e qasjes dhe të drejtën private, veprojnë në përputhje me dispozitat ligjore, autorizimet e dhëna nuk guxon t'i përdorë në përfitime personale apo ndonjë përfitim tjetër.

-Arkivistët i kundërvihen çdo presioni pa marrë parasysh nga vjen, qëllimi i të cilit është manipulimi me dëshmitë, fshehja apo falsifikimi i fakteve.

-Arkivistët nuk guxojnë t'i zbulojnë apo t'i shfrytëzojnë informatat që kanë marrë nga fondet arkivore, ata nuk lejojnë që interesat e tyre personale, për hulumtime dhe botime, të vijnë në kundërshtim me detyrat profesionale.

-Nuk lejojnë askujt jashtë lëmit të tyre të ndërhyjnë në punët dhe detyrat profesionale të tyre, ruajnë fshehtësinë e dokumenteve zyrtare, të cilat i kanë pranuar dhe mbajnë përgjegjësi për tjetërsimin, humbjen dhe keqpërdorimin e tyre.

-Arkivistët janë participantë të rëndësishëm në procesin e përcjelljes së informatave nga një gjeneratë në tjetrën. Përveç këtyre detyrave duhet të kenë parasysh edhe funksionet tjera që lidhen me misionin e tyre.

-Puna e arkivistit në asnjë mënyrë nuk mund të jetë e izoluar dhe shkëputur nga veprimtaritë tjera të përafërta.

Arkivi qendror dhe arkivat tjera në Policinë e Kosovës janë pasuri e dokumentuar, thesar i çmuar që ruajnë kujtesën, të kaluarën që nga krijimi dhe zhvillimit të këtij institucioni.



KURIOZITETE

Kufjet inteligjente flasin gjuhën që do ti

Problemi me gjuhët e huaja është një kujtim i së shkuarsë, sot mjaftojnë vetëm një palë kufje inteligjente për të folur në të gjitha gjuhët e botes. Keto probleme kanë mbaruar dhe zgjidhjen e ka gjetur Google.

Disa ditë më parë Big. G gjatë prezantimit të telefonave të rinj të serisë Pixel I ka zbuluar gjithashtu botën Pixel Bud, kufje të vecanta pa tela lidhëse që përveç se kryejnë funksione tipike të kufjeve moderne janë të lidhura dhe me Google.

Pixel Bud lejojnë dy persona të flasin gjuhë të ndryshme ndërmjet tyre. Secili prej tyre do të komunikojë në idiomat e tyre dhe kufjet e tjetrit do perkthejnë të gjitha fjalë për fjalë. Falë Pixel Bud të shëtisësh botën për turizëm apo punë nuk është më problem.

Kufjet funksionojnë më së miri dhe perkthimi është thuajse I menjëhershëm pa asnjë vonësë. Natyrisht, efikasiteti i sistemit lidhet me shpejtësinë e lidhjes në Internet nëse jeni në vende ku rrjeti nuk është veçanërisht i fuqishëm, përvoja mund të jetë më pak e kënaqshme.

Sapo PixelBud, lidhet me smartphone, shfrytëzon fuqinë e Google Translate dhe lejon bisedën në 40 gjuhë të ndryshme. Bateria e kufjeve inteligjente zgjat deri në 5 orë.

Ata kushtojnë 159,00 dollarë dhe mund të blien online nëpërmjet internetit. Thjesht vendosni një nga dy kufjet zgjidhni përmes aplikacionit dy gjuhët në të cilat dëshironi të flisni dhe pjesën tjetër do ta bëjë softueri.

Hyri për të vjedhur, "skifteri" ngec në dritare për 5 orë

Një hajdut u bë objekt tallje në rrjetet sociale pasi gjatë një vjedhje të dështuar në një fast food u kap nga policia në një pozicion aspak të favorshëm për të.

Hajduti i paidentifikuar nga Birmingham në tentativë për tu larguar nga dyqani ngeci në dritare dhe u bllokua për rreth 5 orë në të, u desh ndërhyrja e policisë për ta shpëtuar pas thirrjeve të këtij të fundit.

Policia publikoi pamjet qesharake të hajdutit ndërsa kishte ngecur në dritare.

Mendoj se do ta kishte të lehtë të kryente vjedhjen e radhës, por këtë herë nuk rezultoi kështu për këtë "skifter" në Angli.



Ia transferuan gabimisht 4.6 milionë dollarë në llogari, e pabesueshme çfarë ndodhi më pas

Një 21-vjeçare është arrestuar në aeroportin e Sydneyt, duke u përpjekur të largohet nga vendi pasi shpenzoi miliona dollarë, që nuk i përkisnin.

Para katër vitesh, Christine Jiaxin Lee, i ra fati nga qielli.

21-vjeçares iu transferuan gabimisht në llogarinë bankare 4,6 milionë dollarë.

Sipas medieve ndërkombëtare, kompjuterët e bankës gabimisht i hodhën asaj shumën marramendëse. Por, Lee e habitur nga kjo dhuratë nisi të bënte shpenzime të çmendura.

Jeta e saj luksoze u ra në sy policëve që nisën një hetim në lidhje me këtë ngjarje. Pas zbardhjes se ngjarjes ajo u arrestua teksa po largohej për në Malajzi. Ajo kishte shpenzuar 3,3 mln dollarë nga shuma që i ishte transferuar gabimisht.



5 pyetjet që zbërthejnë çdo person

Të gjithë biem dakord se, kur takon një njeri të ri, sido qofshin rrethanat, nuk është e lehtë ta njohësh.

Në fillim mund të të duket se krijon një mendim të saktë rreth tij, por mjaftojnë edhe dy-tri situata për të kuptuar që je gabim.

Të gjithë miqtë, bashkëpunëtorët, fqinjët, kanë qenë dikur të panjohur

dhe, po të kujtoheni, mund ta keni nisur marrëdhënien edhe me situatë konfliktuale.

Për ta kuptuar tjetrin më mirë, nëse jeni të interesuar, janë disa pyetje që ua lehtësojnë procesin e njohjes.

Sipas psikologëve, 5 pyetjet e mëposhtme do shpërfaqin më lehtë tiparet e personalitetit të tjetrit. Sigurisht, nëse nuk është gënjeshtar...

1. Si do ta përshkruaje veten?

2. Cilat janë ambiciet e tua?

Ku kërkon të shkosh?

3. Më thuaj titujt e disa librave që ke lexuar

4. Çfarë muzike dëgjon?

5. Cila është puna jote e ëndrrave?

A e dini pse "ambulancë" shkruhet mbrapsht?

Kur ju shihni një veturë të ambulancës në rrugë ju patjetër do të vini re se fjala "Ambulance" është shkruar mbrapsht, si 'Ecnalubma'. Mirëpo a thua pse?

Sigurisht të gjithë e dinë efektin e pasqyrës, krahu juaj i djathtë bëhet i majtë, numri 2 bëhet 5, gjithashtu, edhe shkronjat përmbysen.

Prandaj, arsyeja kryesore dhe e vetmja për këtë është që kjo fjalë të jetë e lexueshme nga shoferët e tjerë. "Ecnalubma" është shkruar në pjesën e përparme të automjeteve në mënyrë që shoferët që janë para këtij automjeti, lehtësisht mund të lexojnë fjalën nga pasqyrat e veturës së tyre, e që lexohet qartë si "Ambulancë".

Nëse nuk do të përmbysesh fjalë, të gjithë shoferët përmes pasqyrës do ta perceptonin si Ecnalubma.

Në këto raste emergjente asnjëherë nuk duhet të hutohemi, edhe pse dikush mund të thotë se e di kur është ambulanca pa e lexuar fjalën qoftë nga dritat apo sirena mirëpo, emri është i domosdoshëm pasi që edhe veturat e policisë kanë drita dhe sirena të ngjashme.



Dëmet që mund t'i shkaktojë kravata

Kravata është shumë e rëndësishme për punën në zyrë, në rastet e prezantimeve apo në takime që kanë vlerë.

Por, nëse mbahet shumë e ngushtë, kravata ul fluksin e gjakut që shkon në tru dhe rrit presionin e brendshëm në sy, duke shkaktuar kështu dhimbje kronike të kokës, shqetësime në veshë dhe pamje jo të qartë.

Nga ana tjetër, lëvizjet e kufizuara të qafës mund të çojnë në tension muskular në shpatulla dhe përgjatë shpinës.

Përgatiti: Çajup KAJTAZI



Programi "International Visitor Leadership Program"/IVLP, ofron praktika më të mira dhe shkëmbim të informatave, ndërmjet përfaqësuesve nga 16 shtete të globit

Përfaqësuesi i Policisë së Kosovës, Drejtori i drejtorisë kundër trafikimit me qenie njerëzore, nënkolonel Fehmi Xhata, është takuar me struktura kompetente në SHBA, pjesë përbërëse e autoritetit në Luftën Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore të të gjitha niveleve, si atë federal, shtetëror dhe lokal, janë shkëmbyer informacione për legjislacionin aktual, mënyrën e funksionimit të mekanizmit zbatues të ligjit, avokim-it-mbrojtës, shërbimet ndaj viktimave, ndjekjes penale dhe politikat e shqiptimit të dënimeve nga organet gjyqësore ndaj të akuzuarve për trafikim me qenie njerëzore.

Pjesëmarrja në panel prezantues lidhur me shkëmbimin e përvojave: Universiteti Incarnate WORD- San ANTONIO, TEMA: Të arriturat, sfidat dhe mekanizmi koordinues në luftën kundër



trafikimit me qenie njerëzore.

Objektivat e përcaktuara nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (DHTQNJ-ja) e PK-së, jo vetëm që janë realizuar por është arritur që të identifikohen edhe nevojat e reja nga përvoja e zbatuesve të ligjit dhe mekanizmit tjetër koordinues në Luftën Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, me qëllim që këto t'i integrojmë dhe t'i bartim në sistemin tonë me të vetmin qëllim të ngritjes së kapaciteteve ekzistuese.

Vlen të potencohet angazhimi dhe përkrahja e drejtorit të Përgjithshëm të PK-së, ICITAP-it amerikan, Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë dhe Divizionit të Trajnimit në Policinë e Kosovës, për realizimin e këtij programi të rëndësishëm.

Policia e Kosovës pjesëmarrëse e Olimpiadës në Los Angeles

Majlinda Ahmetaj Canolli, është zyrtare policore e cila konkretisht punon në SIPK- zyra për të kaluarën kriminale në stacionin 'Qendra' në Prishtinë.

Përkrah punës si police, ajo merret edhe me një aktivitet atraktiv sportiv, atletikën.

Pas pjesëmarrjes nëpër garat vendore si atlete dhe arritjes së rezultateve në këtë fushë prej gushtit të këtij vitit ka përfaqësuar Policinë e Kosovës në olimpiadën policore të mbajtur në Los Angeles të Kalifornisë në të cilën kanë marrë pjesë mbi 90 shtete.

Në këtë olimpiadë ka garuar në 4 disiplina të vrapimit:

1500 M-vendi i katërt, 2000 M- me pengesa –vendi i parë medalje të artë, 5000 M-vendi i tretë medalje të bronzë, 10000 M-vendi i katërt.

